



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 41 Akti**

**Nr. 80 Vendimi**

**Tiranë, më 23.11.2018**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Peter Kijlstra, më datë 22 nëntor 2018, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:**

**Z. Shpëtim M. Kurti**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar, me deklaram në seancë, nga z. Eritan Shehu, avokat i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me licencë nr. 1421.

**OBJEKTI:**

**Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**  
**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 49/2012** “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Lulzim Hamitaj, subjektin e rivlerësimit dhe përfaqësuesin e tij, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit Shpëtim Kurti, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 22.11.2018 kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

- a- Z. Shpëtim Kurti, për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016<sup>1</sup>;
- b- Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kandidatit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt rivlerësimi. më datë 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit”, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, (në vijim referuar si “Komisioni”);
- c- Pas hedhjes së shortit, trupi gjykues nr. 3, pasi administroi dhe studioi tre raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 14.12.2017, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohet kryesuesi i trupit gjykues, znj. Brunilda Bekteshi. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit, me përjashtim të komisionerit Olsi Komici, i cili paraqiti kërkesë për dorëheqjen e tij nga kjo çështje. Më pas, trupi i shortuar për shqyrtimin e kësaj kërkesë dorëheqjeje, e pranoi atë, dhe në vend të anëtarit të dorëhequr u pozicionua anëtari zëvendësues i trupës nr. 3 - komisioneri Roland Ilia - (i shortuar si zëvendësues qysh më 30 nëntor 2017);
- d- Në lidhje me ecurinë e fazës hetimore mbi rivlerësimin e z. Shpëtim Kurti, specifikohet që, pasi Komisioni kishte zhvilluar një fazë hetimore, në vijim të së cilës, trupi gjykues, me vendimin nr.

<sup>1</sup> Paragrafi 3, i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim referuar si “ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se: “Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*”.

2, kishte vendosur mbylljen e hetimeve, vetëm për kriterin e pasurisë dhe, më datë 18 maj 2018, i kishte njoftuar subjektin të rivlerësimit rezultatet respektivë;

- e- Pasi shqyrtoi shpjegimet, dokumentacionin e depozituar dhe kërkesat e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues me vendimin nr. 3, më datë 04.07.2018, vendosi rihapjen e hetimit mbi të tri kriteret e rivlerësimit, i cili i është njoftuar subjektit të rivlerësimit, më datë 06.07.2018;
- f- Në vijim të hapave të mëtejshëm hetimorë, më datë 13 nëntor 2018, me vendimin nr. 4, trupi gjykues vendosi të rimbyllë fazën hetimore, dhe në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për z. Shpëtim Kurti, të bazohej vetëm në dy kriteret e rivlerësimit dhe përkatësisht, në kontrollin e pasurisë dhe në atë të figurës;
- g- Më datë 14.11.2018, Komisioni, njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht, dhe anekset relative; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda datës 20 nëntor 2018; (iii) për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative;
- h- Më datë 20.11.2018, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e tij, të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, mbi rezultatet e hetimit kryesisht;
- i- Po më datë 20.11.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 5 vendosi të ftoj, – përmes postës elektronike, – subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 22 nëntor 2018. Datë në të cilën u zhvillua rregullisht seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent, së bashku me përfaqësuesin e tij ligjor.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Shpëtim Kurti, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Peter Kijlstra.
- ii. Relatori i çështjes, paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë hetimeve të kryera si në fazën e parë vetëm mbi kriterin e pasurisë, dhe në fazën e dytë (pas rihapjes së hetimeve, të mbi të tri kriteret e rivlerësimit), të kaluara si barrë prove për kriterin e pasurisë dhe të kontrollit të figurës;
- iii. Pasi dëgjoi relacionin, z. Shpëtim Kurti dhe përfaqësuesin e tij ligjor shprehën qëndrimin e subjektit, duke parashtruar shpjegimet përkatëse të detajuara lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.
- iv. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit gjatë seancës depozitoi pranë Komisionit parashtrimet/konkluzionet e tij përfundimtare, edhe me shkrim, në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e tij përfundimtar të argumentuar dhe në konkluzion, ai kërkoi konfirmimin e tij në detyrë.

- v. Seanca dëgjimore e datës 22.11.2018 u ndërpre, për të rifilluar më datë 23.11.2018, për shpalljen e vendimit.
- vi. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të konkludojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin, z. Shpëtim Kurti, duke u bazuar vetëm mbi dy kritere të rivlerësimit, dhe specifikisht mbi kriterin e rivlerësimit të pasurisë dhe në atë të kontrollit të figurës.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

- a- Z. Shpëtim Kurti ka dhënë përgjigje dhe ka paraqitur dokumentacion mbështetës, pranë Komisionit, edhe në lidhje me burimet financiare të z. M. Kurti dhe të z. Z. Kurti, respektivisht babai dhe vëllai i tij, - të dy persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

### **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) provat e dorëzuara nga vetë Subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI; c) raportet dhe informacionet mbi Kontrollin e Figurës, të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK; d) dokumentacionin e klasifikuar për të cilin u mundësua njohja dhe vlerësimi nga ana e Trupit Gjykues, gjatë fazës hetimore; e) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; f) gjetjet e paraqitura nga Operacioni Ndërkombëtar Monitorimit pranë Komisionit, - në bazë të nenit “B” të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; g) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; h) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore - për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; i) deklaratimet e personave të tjerë të lidhur; j) faktet e njohura botërisht.

#### **A - Procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë**

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 16.11.2017, raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Shpëtim Kurti, ku konstatohet se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*

- ka kryer fshehje të pasurisë;
- ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

## Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në:

### **1. Në lidhje me blerjen e apartamentit me sipërfaqe 48 m<sup>2</sup>, të ndodhur në, (\*\*\*) - Tiranë.**

Subjekti i rivlerësimit, për blerjen e kësaj pasurie, ka deklaruar si burim financiar shitjen e një tjetër apartamenti, me sip. 84 m<sup>2</sup> - në Kukës, i cili ishte marrë nga Enti Kombëtar i Banesave, dega Kukës, **nëpërmjet një kredie për të pastrehët**, - sipas **ligjit nr. 8030/1995** dhe modifikimeve të tij.

**Në lidhje me kredinë e sipërpërmendur**, janë analizuar aktet në vijim:

**a - kontrata e shitjes me kusht, më datë 28.12.2000**, e lidhur nga subjekti me Drejtorinë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave, nëpërmjet të cilës ishte blerë **apartamenti i banimit** në qytetin e Kukësit, me sipërfaqe 84 m<sup>2</sup> dhe **me vlerë 850.792 lekë**, në cilësinë e poseduesit të **“statusit si i pa strehë”**;

**b - kontrata shtesë e shitjes në fjalë, më datë 24.01.2002** me objekt **“zbritja e çmimit të shitjes së apartamentit”** ku **shuma e përfituar falas llogaritet në shifrën 602.208 lekë** dhe për rrjedhojë **detyrimi financiar** i mbetur pas kësaj zbritje **kalonte nga çmimi fillestar në vlerën prej 1.511.120 lekësh, në 850.792 lekë**;

**c – Ligji nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, i ndryshuar nga ligji nr. 8647, datë 24.07.2000, si dhe një sërë aktesh të tjera nënligjore – mbi bazën e të cilave këto kontrata janë lidhur;**

**d-** Në dosjen e Entit Kombëtar të Banesave, të përcjellë në Komision, me shkresën nr. (\*\*\*) prot, datë 27 prill 2018, është konstatuar prezenca e një certifikate të përbërjes familjare të subjektit të rivlerësimit - të lëshuar më datë 01.12.1992, - nga e cila rezulton se kryefamiljar është z. Shpëtim Kurti (dhe jo i ati z. M. Kurti, që aty rezulton si anëtar familje). Ndërsa në një tjetër certifikatë të gjendjes familjare, më datë 31.12.1992, kryefamiljar rezulton z. M. Kurti (babai i subjektit) dhe si anëtarë të kësaj familje, veç të tjerash, është pasqyruar edhe emri i z. Shpëtim Kurti. Pra në një diferencë kohe një mujore, rezulton se ka ndryshuar dy herë gjendja familjare për sa i përket kryefamiljarit;

**e-** Shkaku i gjetjeve të mësipërme mund të shpjegohet nga përmbajtja e VKM-së, nr. 250, datë 16.04.1996, me titull: **“Për procedurat dhe prioritetet në zbatim të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, ‘Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha’ ”**, pika 3 e të cilit parashikon që: **“Lista e familjeve**

të pastreha duhet të përmbajnë: a) Emrin, atësinë dhe mbiemrin e kryefamiljarit; b) Numrin e pjesëtarëve të familjes; c) Madhësinë e apartamentit tip që i takon kësaj familje. **Të dhënat e mësipërme bazohen në certifikatën e gjendjes familjare të datës 01.12.1992.**”

Nga sa më lart ka rezultuar se:

- i. Ka një **mospërputhje** midis faktit që subjektit të rivlerësimit i është dhënë/njohur **statusi si “familje e pa strehë”**, dhe faktit që **ai ka pasur në bashkëpronësi një banesë si dhe ka përfituar tokë nga ligji nr. 7501/1991;**
- ii. Gjithashtu, mospërputhje kanë rezultuar edhe midis sipërfaqes së tokës që realisht është përfituar dhe deklaruar.

**f-** Po ashtu **ligji nr. 8030, datë 15.11.1995**, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, në nenin 12 parashikon se: **“Nuk përfitojnë nga ky ligj familjet e pastreha, në të cilat qoftë edhe një anëtar i tyre: 1. Ka përfituar nga ligji nr.7501 “Për tokën””**

**g-** Në rastin konkret **subjekti i rivlerësimit**, - ashtu siç edhe ai vetë e ka deklaruar në deklaratën e vitit 2003 si dhe në deklaratën “Vetting”, - **ka qenë dhe vijon të jetë bashkëpronar i shtëpisë dykatëshe me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup> dhe i një sipërfaqe toke prej 1(një) hektar përfituar nga ligji nr. 7501/1991.** Por kjo sipërfaqe toke në deklaratën “Vetting” është deklaruar prej 6.310 m<sup>2</sup>.

**h-** Gjithashtu këtë fakt e vërteton edhe **Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi**, i Rrethit Has, më datë 01.01.1995, **ku rezulton se familjes së z. M. Kurti i është dhënë në pronësi tokë me një sipërfaqe prej 6.310 m<sup>2</sup>**, (dhe jo një hektar sa është deklaruar nga subjekti, në vitin 2003).

## **1.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me mospërputhjet e deklarimeve mbi këtë pasuri.**

Në lidhje me sa më lart, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

- *Është e vërtetë që sasia e sipërfaqes së tokës së deklaruar në “Vetting” nuk përkon me atë të marrë në terren dhe as me atë të deklaruar në vitin 2003, por sasia e tokës e marrë nga familja e subjektit është përfituar - sikurse edhe nga familjet e tjera të asaj zone - në bazë të pjesëve/pronave të trashëguara ndër breza, pra sipas pronave të bazuara te kufijtë e vjetër dhe jo aq sa mund të takonte në bazë të ligjit nr. 7501, edhe pse baza ligjore për marrjen e kësaj toke ishte ky ligj;*
- *Për sa i takon marrjes së statusit të pa strehë, subjekti i rivlerësimit pohon se ai nuk e ka mohuar apo fshehur faktin që ishte përfitues i tokës bujqësore, dhe moskonsiderimi i kësaj pengese nga ana e Këshillit Bashkiak, që ka vendosur dhënien e këtij statusi për të, nuk është përgjegjësi e tij. Ai thjeshtë ka paraqitur kërkesën dhe ka përfituar statusin, pasi organet kompetente, për verifikimin e kritereve, e kanë gjetur të drejtë dhe të ligjshme këtë kërkesë, përderisa e kanë pranuar. Ai nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi as ligjore dhe as morale për sa kohë nuk ka pasqyruar fakte dhe rrethana të rreme.*

## **1.2 Arsytimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

Në vijim të sa më lart është pasqyruar, mbi problematikat e kësaj pasurie, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklaratën “Vetting”, - nisur nga fakti që është përshkruar një sipërfaqe toke e ndryshme krahasuar me atë që ai dhe familjarët e tij posedojnë *de facto*.

## **2. Në lidhje me tokën me sipërfaqe 146 m<sup>2</sup>, në Tiranë**

Në deklaratën “Vetting”, në faqen 6, pika 4, në lidhje me truallin me sip.146 m<sup>2</sup> dhe ndërtesës me sip. 52 m<sup>2</sup>, subjekti ka deklaruar se i ka blerë me të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 83,7 m<sup>2</sup>, të ndodhur në, Rr. (\*\*\*), Tiranë, në vitin 2011. Ky apartament ishte blerë nga zoti Z. Kurti (vëllai i subjektit), me çmim prej 10.888.000 lekësh – ekzakësisht sa ishte rivlerësuar disa javë përpara sesa të kryhej kjo shitblerje;

- i. Nga verifikime të mëtejshme, të bëra nga Komisioni, rezultoi se z. Z. Kurti, në vitin 2011, nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar një investim prej 10.888.000 lekësh. Sa më lart bazohet në faktet që Komisioni ka konstatuar dhe që renditen në vijim;
- ii. Nuk duket se z. Z. Kurti të kishte pasur të depozituara në sistemin bankar shuma të mjaftueshme parash për të justifikuar këtë investim;
- iii. Nuk rezultoi që ai të kishte qenë i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit apo pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat apo publik, nga ku mund të kishte përfituar këto të ardhura;
- iv. I pyetur mbi burimin në origjinë të këtyre të ardhurave, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur që vëllai i tij, z. Z. Kurti, ka jetuar dhe ka punuar në Angli, prej vitit 1999 deri në vitin 2007;
- v. **Subjekti ka përcjellë pranë Komisionit dokumentacion në lidhje me prezencën e z. Z. Kurti, në Angli, si dhe një shkresë/deklarim të shoqërisë “(\*\*\*\*)”, të datës 29.05.2018, sipas të cilës z. Z. Kurti kishte qenë nënkontraktor fiks i kësaj kompanie, nga data 7 shkurt 2000 deri në datën 20 janar 2006, për një total prej 1.208 ditë pune dhe me një pagesë ditore që shkonte nga 115 GBP në 135 GBP;**
- vi. **Sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, të bazuara në shkresën e sipërpërmendur, vëllai i tij, (z. Z. Kurti), kishte fituar të ardhura nga puna në Angli mbi 136.504 GBP;**
- vii. Komisioni, vlerësoi se nuk ishte provuar në mënyrë bindëse: as kohëzgjatja e qëndrimit të z. Z. Kurti në Angli; as shumat e përfituara dhe as pagesa e tatimeve që mund të legjitimonin këto fitime, dhe as nuk u paraqit ndonjë dokument bankar ku mund të provohet që kishin qenë të depozituara apo që të ishin transferuar të ardhurat e pretenduara;
- viii. Për këto arsye, në vijim të hetimeve, Komisioni, thirri dhe dëgjoi z. Z. Kurti, më datë 18.07.2018, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, i cili konfirmoi marrëdhënien tregtare me subjektin e rivlerësimit;
- ix. Gjithashtu, z. Z. Kurti, pohoi se kishte qenë për shumë vite në Angli, ku kishte punuar vazhdimisht dhe në qytete të ndryshme. Në vitet 2000 - 2006 ai pohoi të kishte punuar si

nënkontraktor për kompaninë “(\*\*\*)” - por ai **nuk mund të shprehej nëse kjo kompani i kishte paguar apo jo taksat në lidhje me punësimin e tij. Ai vetë nuk kishte paguar ndonjëherë taksa**, pasi ato duhej të paguheshin në burim, pra nga punëdhënësi, por edhe për faktin se ai kishte qëndruar në Angli si emigrant (klandestin), i pa pajisur me leje qëndrimi. Për këtë arsye atij nuk i mundësohej hapja e llogarive bankare normale ku ai mund të depozitonte të ardhurat e tij, të cilat i kishte dërguar tek babai i vet nëpërmjet shërbimeve të “Western Union” ose me persona të njohur që niseshin nga Anglia për në Shqipëri;

- x. Veç të tjerash, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion provues për të ardhurat e vëllait të tij, të realizuara në Shqipëri, në periudhën 2008 - 2011, në shumën prej 2.348.677 lekësh;
- xi. Ndërkohë, më datë 04 tetor 2018, **ONM-ja ka paraqitur** panë Komisionit, - në zbatim të nenit “B” të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 - **një gjetje në lidhje me provueshmërinë e deklaratës së paraqitur nga subjekti, si të përpiluar nga kompania “(\*\*\*)”, të firmosur, më datë 29 maj 2018, nga zoti P. S., në cilësinë e kontrolluesit financiar të kësaj kompanie;**
- xii. Nga kjo gjetje e ONM-së rezulton se, pas shumë komunikimesh të mbajtura me Qendrën Kombëtare Britanike të Biznesit, ishte konstatuar se kompania angleze në fjalë gjendej në statusin “*në likuidim*”;
- xiii. Gjithashtu, pas kontaktimeve dhe komunikimeve që ONM-ja kishte kryer me likuiduesit dhe njëkohësisht, tashmë, përfaqësuesit ligjor të shoqërisë “(\*\*\*) *në likuidim*”, kishte rezultuar se **shkresa në fjalë nuk ishte konfirmuar si e lëshuar nga kjo kompani**, madje ishte specifikuar se:
  - a- **kjo shoqëri prej muajt gusht të vitit 2007, nuk kishte si të punësuar një person me gjeneralitet e zotrisë, P. S., që kishte firmosur atë shkresë;**
  - b- **gjithsesi ai person (P. S.), nuk kishte punuar ndonjëherë në sektorin e financës, pra nuk kishte qenë kurrë kontrollues financiar për këtë shoqëri;**
  - c- **dokumenti/deklarata e paraqitur si e firmosura nga zoti P. S., nuk mund të jetë hartuar dhe lëshuar nga persona të autorizuar dhe për llogari të asaj kompanie pasi, veç të tjerash, në krye të deklaratës mungon edhe specifikimi “*në likuidim*”, përbri fjalëve “(\*\*\*)”.**

**2.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me paprovueshmërinë dhe pabesueshmërinë e deklaratës së kompanisë “(\*\*\*)” dhe mbi mungesën e burimit të ligjshëm në origjinë.**

Në lidhje me sa më lart subjekti i rivlerësimit, veç të tjerash, ka pohuar se:



- i. *Së pari vëllai dhe babai i tij, nuk janë persona të lidhur me të, por persona të tjerë të lidhur, dhe duke mos pasur cilësinë e dhuruesit ose të huadhënësit, ata nuk kanë detyrim ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre;*
- ii. *Megjithatë, si subjekti i rivlerësimit dhe po ashtu edhe vëllai i tij, z. Z. Kurti, kanë shprehur gatishmërinë e tyre dhe konkretisht kanë dhënë vullnetarisht përgjigje dhe shpjegime mbi pyetjet dhe dyshimet e ngritura nga Komisioni lidhur me ligjshmërinë e burimeve financiare të përdorura për krijimin e pasurive të tyre si dhe të babait të tyre, z. M. Kurti;*
- iii. *Siç u tha edhe më lart, pretendimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit ishin se burimet financiare të investimeve të kryera nga z. Z. Kurti si dhe nga z. M. Kurti, ishin siguruar nga kursimet e realizuara nga z. Z. Kurti, kryesisht gjatë viteve kur ai kishte jetuar dhe punuar në Angli. Ky version është konfirmuar edhe nga vetë z. Z. Kurti, gjatë dëgjësës së tij pranë Komisionit;*
- iv. *Sipas subjektit të rivlerësimit, dokumentacioni i paraqitur nga vetë ai, në lidhje me të ardhurat e vëllait të tij të përfituara në Angli, ka qenë në përputhje me deklaratimet e këtij të fundit dhe i mjaftueshëm për të provuar burimin e ligjshëm të kursimeve në fjalë;*
- v. *Gjithashtu, z. Shpëtim Kurti, ka nënvizuar faktin që vëllai i tij ka pasur edhe kursime të tjera nga puna në Shqipëri, si dhe faktin që ai ka pasur disponibilitet financiar, siç vërtetohet edhe nga shitblerja e kryer prej tij të një apartamenti në durrës, në vitin 2009;*
- vi. *Po ashtu subjekti ka vënë në pah faktin që, z. Z. Kurti, ka transferuar shuma të caktuara valute nga Anglia në Shqipëri, nëpërmjet shoqërisë Western Union, por meqenëse kjo kompani i mban të dhënat mbi aktivitetin e vet, vetëm për pesë vjet, ka rezultuar e pamundur për z. Kurti që të provojë këtë rrethanë;*
- vii. *Së fundmi, në lidhje me mungesën mbi shkresën e sipërcituar të termit/saktësimit “në likuidim” përbri emrit të kompanisë angleze, - si një tjetër element që e bën të pabesueshme hipotezën e redaktimit të atij dokumenti nga kompania në fjalë - subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se: “... edhe pse shkresat e lëshuara nga kompania “(\*\*\*)”, datojnë 28 maj dhe 29 qershor 2018, ato kanë të njëjtën përmbajtje të shkresave të lëshuara në vitet 1999 - 2007, kur ajo shoqëri nuk ka qenë në likuidim, dhe për këtë arsye nuk është konsideruar logjike nga personi në fjalë që të shënohej kjo pjesë...”*

## **2.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm**

- i. Komisioni e konsideron si detyrë e tij të administrojë, shqyrtojë, vlerësojë dhe përdorë të gjithë dokumentacionin apo informacionin që ka lidhje me objektin e çështjes në shqyrtim, dhe natyrisht përfshirë këtu edhe provat e paraqitura vullnetarisht nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit të tij;
- ii. Kështu që, për sa i përket detyrimit ligjor ose jo për të dhënë shpjegime apo prova nga vëllai dhe babai i subjektit të rivlerësimit, mbi ligjshmërinë e burimit të pasurive të tyre si persona të tjerë të lidhur, Komisioni, çmon që trupi gjykues jo vetëm që mund por ai duhet të analizojë dhe të përdorë - kur e vlerëson të dobishme në funksion të vendimmarrjes -

- çdo provë që është paraqitur, që është marrë apo që ka mbërritur pranë tij, përfshirë këtu edhe ato që janë paraqitur prej vetë z. Shpëtim Kurti ose nga vëllai i tij përgjatë hetimit administrativ;
- iii. Kështu që, **fokusimi tek ekzistenca apo jo, e detyrimit në ngarkim të personave të tjerë të lidhur, për të dhënë shpjegime, nuk duket e rëndësishme në këtë moment dhe rrethanë, për aq kohë sa** – siç u tha edhe më lart – edhe në lidhje me verifikimin e burimit të ligjshëm të pasurive të personave të tjerë të lidhur, **Komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit**, përkrah të gjitha deklarimeve të tjera, dokumenteve dhe informacioneve të administruara prej tij, tërësisht në respekt të dispozitave që rregullojnë procedurat e marrjes së provave;
- iv. Po ashtu, **shkresa e kompanisë “(\*\*\*)” është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit me pretendimin se nëpërmjet saj provohej përfitimi i shumave të konsiderueshme prej vëllait të tij nga puna në Angli**. Në këto kushte, Komisioni i kërkoi subjektit që ky dokument duhej të ishte me firmë të autentikuar nga një noter anglez, para të cilit duhej të identifikohet personi nënshkruar dhe të specifikohet cilësia dhe funksioni i tij brenda kompanisë në fjalë – pra edhe firma të vendosej përpara noterit, që duhej të certifikonte atë;
- v. Kërkesat e mësipërme të Komisionit u përmbushën vetëm pjesërisht, ose vetëm për sa i përket bërjes së një kopje të njëzuar nga noteri anglez, me origjinalin dhe përkthimi, por jo në mënyrat dhe format e kërkuara, si më lart;
- vi. Për më tepër, **vërtetësia dhe provueshmëria e shkresës në fjalë është rrëzuar nga gjetja e ONM-së**, që, siç u tha edhe më lart, ka qartësuar faktin që: *“Shoqëria “(\*\*\*)”, nuk ka pasur në radhët e saj asnjë të punësuar, me emrin e nënshkruarit të kësaj shkrese – z. P. S. – qysh prej vitit 2007<sup>2</sup>, dhe që ai nuk kishte qenë ndonjëherë kontrollues financiar – siç rezultonte të ishte vetëquajtur nënshkruar i shkresës së datës 29 maj 2018;*
- vii. **Si dhe dokumenti/deklarata e paraqitur si e firmosura nga zoti P. S., nuk mund të ishte hartuar dhe lëshuar nga persona të autorizuar dhe për llogari të asaj kompanie;**
- viii. Po ashtu, **autenticiteti i shkresës në fjalë është mohuar nga përfaqësuesit ligjor aktual (dhe likuidues) të kompanisë “(\*\*\*)” në likuidim**, pasi këta të fundit – sipas procedurave normale – redaktojnë, nënshkruajnë dhe përcjellin shkresa në emër të kësaj shoqërie duke specifikuar/shtuar përbri emrit të kompanisë edhe statusin *“në likuidim”*, gjë që mungonte te shkresa e paraqitur pranë Komisionit;
- ix. **Kjo do të thotë që subjekti ka paraqitur si provë një dokument jo autentik, për sa u arsyetua edhe më lart, dhe për rrjedhojë, rezulton qartë se ka dështuar tentativa e kryer nga subjekti i rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave – në kuptimin e ligjit nr. 84/2016 - të vëllait të tij, me të cilat ai ka investuar për blerjen e vitit 2011, të apartamentit pikërisht të subjektit të rivlerësimit. Dhe për rrjedhojë ka dështuar të provojë edhe burimin e ligjshëm në origjinë, për sa i përket investimit të kryer nga vetë, z. Shpëtim Kurti, në vitin 2012 për blerje të truallit me sip. 146 m<sup>2</sup>**

<sup>2</sup> Pikërisht viti kur, z. Z. Kurti, ishte larguar përfundimisht nga Anglia.

dhe të ndërtesës me sip. 52 m<sup>2</sup>, pasi ai është deklaruar në “Vetting” si burim financiar i realizuar me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të tij ndodhur në, Rr. “(\*\*\*)” (tek vëllai). Ai gjithashtu ka munguar të provojë dhe të japë shpjegime të besueshme mbi burimin e ligjshëm të pasurive dhe ka kryer deklarim të pasaktë të pasurisë në posedim (neni D, pika 5, të Aneksi të Kushtetutës);

- x. Së fundmi, Komisioni thekson, se, ndryshe nga sa pretendohet nga subjekti, trupi gjykues nuk i ka injoruar provat mbi burimet e ligjshme të të ardhurave të përfituara nga z. Z. Kurti në Shqipëri, si edhe fitimet nga pensioni i përfitur nga z. M. Kurti, por gjithsesi këto të ardhura nuk justifikojnë investimet e sipërcituara dhe as ato për të cilat do të flitet në vijim.

**Si konkluzion, subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm të këtij aseti, sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.**

### **3. Mbi kursimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit**

**Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, një shumë prej 58.000 eurosh, si kursime, burimi kryesor i të cilave ishte nga shitja e apartamentit të ndodhur në, Rr.” (\*\*\*)”, Tiranë, tek vëllai i tij. Në lidhje me këto të ardhura / me këtë burim financiar, trupi gjykues i referohet arsyetimit lidhur me tokën me sip. 146 m<sup>2</sup>. Duke u bazuar në atë arsyetim trupi gjykues arrin në konkluzionin se gjithashtu edhe burimi i këtyre kursimeve është i pa justifikuar me të ardhura të ligjshme, dhe për rrjedhojë edhe këtu është i aplikueshëm neni 61, pika 3, e ligjit nr. 84/2016.**

### **4. Mbi përdorimin e apartamentit të babait të subjektit të rivlerësimit, z. M. Kurti, pa pagesë qiraje.**

- a. Komisioni ka vlerësuar që të hetonte edhe mbi pasuritë dhe mbi burimet financiare të z. M. Kurti (babai i subjektit) pasi, siç u tha edhe më lart, edhe ky kualifikohet si **person tjetër i lidhur (në cilësinë e dhuruesit ose të huadhënësit)** me z. Shpëtim Kurti, në sajë të kontratës së dhënies në përdorim të subjektit, të apartamentit të ndodhur në, Rr. “(\*\*\*)”, pa kompensim/pagesë, prej shumë vitesh - siç është deklaruar edhe nga vet subjekti.
- b. Në vijim të hetimeve të kryera nga Komisioni ka rezultuar se, z. M. Kurti, ka blerë një **apartament me sipërfaqe 135 m<sup>2</sup>**, në Rr. “(\*\*\*)” - me kontratë porosie të datës 15.10.2004, me çmim të caktuar në shumën **59.400 euro**, si dhe **një garazh me dy vende parkimi**, po në të njëjtën adresë, me kontratë porosie të datës 23 janar 2007, me çmim të caktuar **në shumën prej 10.000 eurosh**. Të dyja këto kontrata rezultojnë të lidhura ndërmjet shtetasit **M. Kurti**, dhe shoqërisë “A” sh.p.k.;
- c. Komisioni ka konstatuar se, **z. M. Kurti, nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar investimet e sipërpërmendura**. Ky konstatim bazohet në sa vijon:

- i. **Ka rezultuar se brenda një harku kohor 4 mujor, (15 tetor 2004 - 15 shkurt 2005), z. M. Kurti i ka paguar shoqërisë “A” sh.p.k., shumën prej 59,400 eurosh, dhe në datën 23 janar 2007, ai i ka paguar edhe 10.000 euro të tjera për garazhin;**
  - ii. Nuk rezulton që z. M. Kurti të ketë qenë në atë periudhë në marrëdhënie punësimi, pasi është konstatuar<sup>3</sup> se ai merr pension pleqërie, që nga viti 2000, në shumën prej **12.802 lekësh në muaj;**
  - iii. Nuk ka rezultuar që z. M. Kurti të ketë qenë i regjistruar pranë QKB-së për ushtrimin e ndonjë aktiviteti tregtar nga i cili mund të kishte përfituar të ardhura;
  - iv. Gjithashtu nuk rezulton që në emër të babait të subjektit të rivlerësimit të ketë ndonjë automjet të regjistruar në emrin e vet, gjë e cila mund të shpjegonte nevojën e tij për blerjen dhe përdorimin e garazhit të sipërpërmendur;
  - v. **Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorëve dhe me sqarimet e tij të mëvonshme, ka pohuar se burimet e të ardhurave me të cilat ka investuar, z. M. Kurti, janë siguruar nga kursimet e djalit tjetër të tij (dhe njëkohësisht vëllait të subjektit), pra nga të ardhurat e z. Z. Kurti;**
  - vi. **Këtë rrethanë e ka pranuar, konfirmuar dhe pohuar edhe vetë z. Z. Kurti, gjatë deklarimeve të tij, të bëra pranë Komisionit;**
- d. Për rrjedhojë, në sajë të analizës dhe arsytetimeve të kryera në pikën 3 (pararendëse), konstatohet dhe konkludohet se edhe në këtë rrethanë ka pasur **mungesa të burimit të ligjshëm**, me të ardhura të pamjaftueshme, **për të justifikuar investimet e sipërcituara, të kryera nga z. M. Kurti. Konkretisht, ky konkluzion, arrihet në bazë të sa u konstatua edhe më sipër**, lidhur me pavërtetësinë e deklaratës së paraqitur si të lëshuar nga “(\*\*\*\*)”, pra **në sajë të dështimit të provueshmërisë së burimit të ligjshëm të shumave të pretenduara si të fituara dhe të kursyera nga z. Z. Kurti, në Angli;**
- e. Edhe në lidhje me këtë pikë konsiderohen si të ripërmendura qëndrimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit si dhe arsyetimet dhe konkluzionet e arritura nga Komisioni, të paraqitura në pikën e mësipërme (nr. 3), pasi burimi i pretenduar i të ardhurave është i njëjti (puna në Angli e z. Z. Kurti) dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti, si tentativë për të provuar burimin e ligjshëm financiar në fjalë, janë po ato të shqyrtuara më lart.

## **B - Procesi i rivlerësimit për kontrollin e figurës**

### **1. Mbi kontrollin e figurës:**

**Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e kontakteve të mundeshe të papërshtatshme, me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin “DH” të Aneksit të Kushtetutës si dhe të ligjit nr. 84/2016.

<sup>3</sup> Në sajë të shkresës/përgjigjes të Sigurimeve Shoqërore të datës 12/07/2017;

- i. Në konkluzion të këtyre verifikimeve, DSIK ka përcjellë në Komision, një raport me shkresën e datës 02 nëntor 2017, në lidhje me Subjektin e rivlerësimit dhe në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.
- Sipas këtij raporti, të deklasifikuar pjesërisht, më datë 29 mars 2018, veç të tjerash rezultoi se:
1. *“... subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme, me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në më shumë se një rast, ....., në vlerësimin e përgjithshëm të kontrollit të figurës, sipas përcaktimeve të germave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, gjykojmë se ky subjekt ka tendencë kriminale për t’u përfshirë në krimin e organizuar dhe mund të vihet nën presion nga këto struktura”;*
  2. *“ .... në lidhje me këtë subjekt përmbushen kërkesat e parashikuara në germet “c” dhe “d” të pikës 4 të nenit 38, - mbi rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, veprimtaria e të cilit është e njohur dhe e dokumentuar, në formën e shkëmbimit të favoreve, parave apo dhuratave, në papajtueshmëri të plotë me detyrën”;*
  3. *“Subjekti nuk ka renditur në deklarin për kontrollin e figurës kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar”;*
  4. *“Grupi i Punës konstaton papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Shpëtim Kurti”.*
- ii. Më datë 06.09.2018, DSIK-ja përcjell përditësimin e parë të raportit të sipërcituar, dhe më vonë, më datë 14 nëntor 2018, raporti i DSIK-së është përditësuar sërish;
  - iii. Sipas këtyre raporteve të përditësuar, konfirmohet konkluzioni i Grupit të Punës mbi papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit dhe përcilleshin detaje shtesë mbi kontaktet e tij të papërshtatshme, me persona të proceduar penalisht;
  - iv. Pra, si **konkluzion DSIK-ja ka konstatuar dhe ka konfirmuar papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, z. Shpëtim M. Kurti, për vazhdimin e detyrës.**

### **1.1 - Hetimi i kryer nga Komisioni mbi kontrollin e figurës**

- a. Në vijim të informacioneve të mësipërme, në bazë të nenit “Ç” të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në bashkëpunim me ONM-në ka kryer disa aksese në dokumentacionin e klasifikuar të poseduar nga Institucionet verifikuese, për t’i studiuar ato si dhe për të verifikuar bazueshmërinë e konkluzioneve në të cilat kishin arritur raportet e sipërpërmendura;
- b. Gjithashtu Komisioni - në sajë të informacioneve të marra nga raportet e DSIK-së por edhe nga denoncimet e publikut, - ka kërkuar, administruar dhe studiuar disa dosje hetimore<sup>4</sup>, ku rezultoni të përfshirë persona me të cilët subjekti i rivlerësimit mund të kishte pasur kontakte ose mund të kishte ndërhyrë/influencuar për një trajtim favorizues ndaj tyre, nga ana e organeve hetimore apo gjyqësore;

<sup>4</sup> Dosjen nr. 8/2006 të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, të transferuar për kompetencë pranë Prokurorisë së Gjirokastrës, me nr. (\*\*\*)/2007; - Dosjen e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, nr. (\*\*\*)/2012, të transferuar pranë Prokurorisë së Tiranës, nr. (\*\*\*)/2013;

- c. Po ashtu janë administruar dhe studiuar disa dosje të tjera profesionale - objekt denoncimi<sup>5</sup> - në një rast, subjekti i rivlerësimit, ka ushtruar rolin e prokurorit më të lartë të prokurorit të çështjes dhe ose të Zv/Drejtnesit të Prokurorisë, dhe për rrjedhojë ai ka pasur një përfshirje direkt ose indirekt dhe ka dhënë ose do të duhej të jepte një kontribut profesional në administrimin dhe adresimin e tyre;

Veç të tjerash, nga studimi i dosjeve të administruara ka rezultuar se:

#### **Cështja e parë:**

1. Më datë 9 janar 2006, Prokuroria e Krimeve të Rënda kishte regjistruar procedimin penal nr. (\*\*\*)/2006, në bazë të nenit 298 “Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufirit” dhe nenit 333/a “Grup i strukturuar kriminal” kundër shtetasve H. M<sup>6</sup>, P. B. dhe personave të tjerë;
2. Në sajë të veprimeve hetimore dhe përgjimeve të ndërmarra nga kjo prokurori, ka rezultuar se mes përgjimesh kjo dosje përmbante edhe një SMS të nisur nga shtetasi P. B. - asokohe nën hetim për krim të organizuar - drejt një tjetër numri telefoni celular (në atë moment poseduesi i tij rezultonte i pa identifikuar). Teksti i mesazhit të nisur përmban një kontakt të ruajtur në celularin dërgues, që i përcjell tjetrit, dhe konkretisht: “Shpëtim Kurti 0.....”
3. Pas rreth një viti, Prokuroria e Krimeve të Rënda vendosi pushimin e çështjes kundër shumë prej të akuzuarve, përfshirë edhe z. P. B. dhe transferoi çështjen kundër z. H. M. dhe një personi tjetër, pranë Prokurorisë së Gjirokastrës (për shkak moskompetencë);
4. Prokuroria e Gjirokastrës ka regjistruar procedimin penal nr. (\*\*\*)/2007, por edhe kjo prokurori, më datë 10 janar 2008, e ka pushuar çështjen kundër shtetasit H. M. dhe personit tjetër;
5. Për sa më lart, veç të tjerash, minimalisht qartëson faktin se shtetasit H. M. dhe P. B., të cilët ishin proceduar penalisht për pjesëmarrje në krim të organizuar, por nuk patën pasoja, pasi çështja u pushua.

#### **Cështja e dytë:**

6. Nga ana tjetër, më datë 30 shtator 2013, sërish Prokuroria e Krimeve të Rënda ka përcjellë dosjen penale nr. (\*\*\*)/2012, pranë Prokurorisë së Tiranës, për shkak moskompetence, - ku ishte sërish i përfshirë shtetasi H. M. dhe të tjerë - pasi grupi i strukturuar kriminal që dyshohej se ishte përfshirë në dhënie ndihme për kalim të paligjshëm kufiri (në bazë të Nenit 298 dhe 333/a të Kodit Penal) - sipas saj - nuk përmbushte kërkesat ligjore minimale për t’u cilësuar si i tillë;
7. Rrjedhimisht, pas këtij transferimi, më datë 1 tetor 2013, Prokuroria e Tiranës regjistroi procedimin penal nr. (\*\*\*)/2013 në bazë të nenit 298 të Kodit Penal, kundër shtetasve: H. M., A. P., Sh. S., A. B., K. B., e të tjerë. Prokuroria e Tiranës rreth një viti, më datë 13 nëntor 2014, shpalli akuzat ndaj H. M., dhe të tjerëve në bazë të nenit 298 të Kodit Penal. Më datë 25 maj 2016, gjykata ka dënuar shtetasin H. M., dhe të tjerët në përputhje me kërkesën e prokurorit të çështjes, me 5 vjet burgim, duke zbritur më pas 1/3 e dënimit;

<sup>5</sup> Dosjet e procedimeve penale: nr. (\*\*\*)/2004; nr. (\*\*\*)/2006; nr. (\*\*\*)/2007; nr. (\*\*\*)/2009; nr. (\*\*\*)/2011; nr. (\*\*\*)/2014; vendim mosfillimi të procedimit penal, nr. (\*\*\*) të vitit 2016; procedimit penal, nr. (\*\*\*)/2016; vendim mosfillimi në procedimin penal për kallëzimin, nr. (\*\*\*)/2017; procedimit penal nr. (\*\*\*)/2017.

<sup>6</sup> Person me të cilin subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte, madje një takim me të dhe me persona të tjerë e ka pranuar edhe vetë, z. Shpëtim Kurti, në seancë dëgjimore.

8. Sipas shënimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Tiranës (asokohe P.F.), i administruar në dosje, rezulton se ka qenë pikërisht subjekti i rivlerësimit, z. Shpëtim Kurti, që në cilësinë e Zëvendës Prokurorit të Rrethit, i ka caktuar këtë çështje prokurorit (E. K.), për ta hetuar;
9. Gjithashtu, rezulton se prokurori i çështjes (E. K.) ka kryer veprime hetimore të kufizuara gjatë periudhës tetor 2013 - nëntor 2014, si:
  - i. Delegimin e veprimeve hetimore te policia gjyqësore;
  - ii. Brenda një jave nga caktimi i çështjes, ai i ka kërkuar gjykatës kompetente që për personat nën hetim të ndryshonte masën e sigurisë nga *arrest në burg* (dhënë nga krimet e rënda) në *arrest në shtëpi*;
  - iii. Ka urdhëruar, brenda 24 ditësh nga caktimi i çështjes, kthimin e 3 telefonave celularë dhe të automjetit të sekuestruar, të njërit prej personave nën hetim (pikërisht H. M.), me motivacionin “*nuk janë të përshtatshme si prova materiale dhe nuk kanë lidhje me veprën penale*”. Vihet gjithashtu në dukje fakti se përfaqësuesi ligjor i shtetasit H. M., kishte kërkuar rikthimin e dy telefonave celularë të sekuestruar, duke pretenduar se ata nuk i përkisnin personit nën hetim (H. M.), por familjarëve të tij<sup>7</sup>;
  - iv. Shtyrjen në çdo 3 muaj<sup>8</sup>, nga tetori 2013 deri në dhjetor 2014, të afatit për kryerjen e hetimit, me arsyetimin se ishte e nevojshme të merreshin dëshmi dhe të përkthehej në frëngjisht letërporosia e çështjes<sup>9</sup>;
  - v. Rezulton se veprimet hetimore të Prokurorisë së Tiranës kanë qenë pasive dhe jo efektive. Provat që prokurori i çështjes i ka bashkëngjitur kësaj kërkesë përmbajnë pothuajse vetëm rezultatet e veprimeve hetimore të ndërmarra nga Prokuroria e Krimeve të Rënda.
  - vi. Prokurori i çështjes i ka kërkuar gjykatës një dënim në minimumin e parashikuar nga ligji për këtë akuzë - *dhënie e ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit, në bashkëpunim*, që është 5 vjet (ligji parashikon dënim maksimal prej 10 vjetësh);
  - vii. Shkaku i kësaj kërkesë minimale, veç të tjerash është shpjeguar nga prokurori i çështjes, me faktin e pendimit të thellë nga ana e të pandehurit/ve - (pendim ky që nuk rezulton të jetë shprehur apo pasqyruar nga asnjë dokument i dosjes. Përkundrazi, për sa u përket akteve në dosje, nga dokumentacioni i paraqitur nga ana e përfaqësuesve ligjorë të personave nën hetim / të akuzuar, rezulton e kundërta);
  - viii. Arsyetimi i prokurorit për kërkesën e minimumit bazohej edhe në moshën e re e të akuzuarve, por kjo është e vështirë të kërkohej pasi rezulton se katër prej tyre ishin midis 38 - 47 vjeç, dhe vetëm njëri prej tyre ishte 27 vjeç. I akuzuari H. M., asokohe ishte 47 vjeç;

<sup>7</sup> Këta telefona u sekuestruan nga ana e Prokurorisë së Krimeve të Rënda në cilësinë e provës materiale, si mjete komunikuese për organizimin e ndihmës ndaj personave për kalimin e paligjshëm të kufirit jashtë shtetit, dhe të përdorura personalisht nga i hetuari. Edhe automjeti i kthyer u sekuestrua nga ana e Krimeve të Rënda, bazuar në dyshimin se automjeti ishte përdorur për transportim, në kuadrin e veprimtarisë kriminale. Nuk kuptohet kush ka qenë shkaku dhe urgjenca e heqjes së sekuestros dhe e kthimit të tyre, pasi ata përbënin mjetet nëpërmjet të cilëve konsumohej vepra penale në fjalë;

<sup>8</sup> Çështja u regjistrua, më datë 01.10.2013. Në cilësinë e prokurorit më të lartë, subjekti i rivlerësimit ka miratuar këto shtyrje të afatit të hetimeve: nga data 26.10.2013 - 26.01.2014; nga data 25.01.2014 - 25.04.2014; nga data 25.04.2014-25.07.2014; nga data 25.07.2014 - 25.10.2014; nga data 25.10.2014 - 31.12.2014. Ndërsa më datë 13.11.2014, prokurori i çështjes u shpalli akuzat personave të akuzuar.

<sup>9</sup> Në dosje u gjetën 57 faqe të përpiluara në gjuhën frënge nga ana e autoriteteve franceze, ndërsa letërporosia dhe përkthimi i saj kishin qenë përkthyer më parë nga ana e Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

- ix. Një tjetër arsye pse u kërkua minimumi i dënimit minimal ishte fakti që të akuzuarit pretendohet se nuk ishin dënuar me pare . Ndërsa ka rezultuar se shtetasi H. M., kishte qenë i dënuar në vitin 2011, për falsifikim monedhash në bashkëpunim;
- x. Gjithashtu, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar të gjitha kompetencat e tij, për të ndryshuar dhe përmirësuar veprimtarinë hetimore vendimet e prokurorit në këtë çështje, - ashtu siç i takonte në bazë të urdhrin nr. 148/2008 të Prokurorit të Përgjithshëm - asokohe në fuqi;
- xi. Në fakt, në lidhje me hierarkinë e Prokurorisë, paragrafi 1, pika 3, i urdhrin nr. 148/2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, parashikonte që: *“prokurori më i lartë ... ka për të detyrë të analizojë dhe vlerësojë zbatimin e parimeve të procesit të drejtë ligjor, të barabartë dhe të rregullt në procedimin penal, në ngritjen e akuzave dhe përfaqësimin e akuzës përpara gjykatës.... Gjithashtu përcaktohet se prokurori më i lartë ka për detyrë të urdhërojë apo të japë udhëzime me shkrim për kryerjen e veprimeve hetimore të nevojshme për kryerjen e hetimeve paraprake...”*.

Në vijim dhe për rrjedhojë të konstatimeve të pasqyruara më lart, Komisionit i rezulton se subjekti ka ushtruar papërshtatshmërisht kompetencat e tij në mënyrë selektive ndaj shtetasit H. M. Kjo përkon me përmbajtjen e denoncimeve dhe të informacioneve të klasifikuara të verifikuara nga trupi gjykues dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar– sipas të cilave, *ka qenë angazhimi dhe ndikimi i paligjshëm i z. Shpëtim Kurti, duke shfrytëzuar pozicionin, që ka favorizuar shtetasin H.M.*

## **1.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me problematikat e konstatuara mbi figurën**

- i. *Në lidhje me kontaktin e papërshtatshëm, subjekti i rivlerësimit, është shprehur se ai nuk e mohon faktin që e ka takuar z. H. M. - të cilin e njeh pasi kanë origjinë krahinore të përbashkët. Takimi ka qenë në mënyrë rastësore, më datë 08.01.2013, në një lokal afër punës, por asokohe, z. H.M., nuk ishte as nën hetime – të cilat nisën pas tre muajsh – dhe as nuk ka qenë ndonjëherë i përfshirë në krimin e organizuar dhe për rrjedhojë, konkluzionet e DSIK-së janë të pabazuara pasi, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë kontakt të papërshtatshëm, me persona të përfshirë në krimin e organizuar;*
- ii. *Ky person ka qenë për shumë kohë nën hetim dhe nëse subjekti do të kishte pasur kontakte të tjera me të, kjo do të ishte pasqyruar në dosjen hetimore;*
- iii. *Po ashtu subjekti nuk e njeh shtetasin P.B., - i cili ka nisur një SMS me emrin e subjektit në tekst - dhe bën prezent faktin që në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile janë 12 persona me emrin “Shpëtim Kurti”;*
- iv. *Në lidhje me hetimin e kryer në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale nr. (\*\*\*)/2013, ndaj shtetasit H.M. etj, subjekti sqaron se ai ka kryer vetëm caktimin e prokurorit të çështjes, dhe ka firmosur një zgjatje hetimi, por nuk ka ndërhyrë, nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, as ka akte të përpiluar, kontrolluar apo firmosur prej tij, as ka urdhëruar apo propozuar ndonjë qëndrim, apo të ketë ushtruar ndonjë ndikim të paligjshëm*



te prokurori i çështjes. Kjo edhe për faktin që prokurori i çështjes H.M., nuk bënte pjesë në grupin e prokurorëve që ishin në linjën që drejtonte subjekti;

- v. Subjekti nuk ka pasur asnjë kontakt me grupin e personave që ndihmonin shtetasit shqiptarë të shkonin drejt Anglisë, dhe ai as për vëllain dhe as për djalin e xhaxhait nuk ka kontaktuar apo ndihmuar për të shkuar në Angli;
- vi. Ngjashmëria e denoncimeve me informacionet e përcjella nga raporti i DSIK-së lënë dyshime se të njëjtët persona paraqesin denoncime gjithandej dhe bëhen vetëm me qëllim dashakeqës dhe që e kanë çuar DSIK-në në konkluzione ireale dhe të pasakta, pa kryer verifikimet e duhura;

### 1.3 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

- i. Në lidhje me kontaktin e papërshtatshëm theksohet që shtetasi H. M. - për të cilin subjekti ka pohuar që e njeh dhe që e ka takuar, sipas tij në mënyrë rastësore - ka qenë i proceduar penalisht, më datë 9 janar 2006, nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, - procedimin penal nr. (\*\*\*)/2006, në bazë të nenit 298 të Kodit Penal: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit” dhe nenit 333/a të Kodit Penal: “Grup i strukturuar kriminal” kundër H. M., P. B. dhe personave të tjerë;
- ii. Edhe pse, në një moment të dytë, akuza në bazë të nenit 333/a të Kodit Penal, është rrëzuar nga vetë Prokuroria e Krimeve të Rënda – por jo me një vendim gjyqësor pafajësie të formës së prerë – cilësimi i shtetasit H. M., si një “person i përfshirë në krimin e organizuar” rezulton të jetë në përputhje me pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016;
- iii. Gjithashtu, trupi gjykues pati mundësinë të verifikojë nëpërmjet studimit të dokumenteve të klasifikuara, që midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit H. M., ka pasur edhe kontakte të tjera jo rastësore – të cilat subjekti i rivlerësimit i ka mohuar;
- iv. Për sa i takon mesazhit të nisur nga celulari i shtetasit P. B., me përmbajtje në tekst *emrin dhe mbiemrin* e subjektit të rivlerësimit si dhe një numër telefoni, Komisioni, arsyeton që edhe pse ekzistenca e të paktën 11 personave të tjerë në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, me emrin, *Shpëtim Kurti*, mund të mos mundësojë provueshmërinë e plotë, në një vlerësim të përgjithshëm ky fakt ka të paktën vlerën e një indice, nga momenti që në atë hetim<sup>10</sup> ishte i përfshirë edhe shtetasi H. M., dhe që njohja e këtij të fundit me subjektin e rivlerësimit është jashtë çdo dyshimi. Gjithashtu edhe njohja dhe bashkëpunimi i ngushtë në aktivitetin e përbashkët të paligjshëm, midis P. B. dhe H. M. është e provuar nga aktet e dosjes së sipërpërmendur. Për rrjedhojë mundësohet edhe lidhja logjike, të paktën indirekte, midis subjektit të rivlerësimit dhe posedimit të emrit dhe numrit të tij nga ana e shtetasit P. B., që i nis ato me mesazh;
- v. Gjithashtu, në bazë të hetimeve të kryera nga Komisioni, përfshirë këtu edhe studimin dhe verifikimin e dokumenteve të klasifikuara, trupi gjykues arrin në përfundimin se faktet e

<sup>10</sup> Nga përgjimet e të cilit rezultoi nisja e mesazhit nga P. B. me emrin e subjektit në tekst.

- përmendura në raportet e DSIK-së, rezultojnë të lidhura dhe të mbështetura nga të dhëna të besueshme;
- vi. Po ashtu, indicet dhe të dhënat e denoncimeve dhe të dosjeve të sipërpërmendura, si dhe informacionet e klasifikuara janë në linjë me raportet dhe me konkluzionet e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar. Mbi këtë pikë, të kundërshtuar nga subjekti<sup>11</sup>, Komisioni qartëson se detyra e tij është të shqyrtojë dhe të vlerësojë më objektivizëm dhe me paanësi të gjitha provat, dokumentet dhe informacionet, pavarësisht prejardhjes së tyre, për të mbërritur në konkluzione të ekuilibruara dhe proporcionale, të bazuara sa më lart dhe në bindjen e brendshme;
  - vii. Vlen për tu theksuar se në këtë rivlerësim ka një specifik që lidhet me njohjen dhe përdorueshmërinë e kufizuar të informacioneve të klasifikuara;
  - viii. Në fakt, ndërsa nga njëra anë anëtarët e trupit gjykues mund të konsultojnë, studiojnë dhe verifikojnë edhe dokumentet e klasifikuara, (siç ka ndodhur në rastin konkret), me detyrimin e vlerësimit të këtyre të dhënave në funksion të vendimmarrjes, - pa e cenuar apo ekspozuar burimin, - nga ana tjetër, ky informacion ose dokumentacion nuk mund të përdoret në aktet publike apo të vihet në dispozicion të subjektit të rivlerësimit dhe/ose të përfaqësuesit të tij ligjor, me përjashtim të pjesëve/informacioneve të deklasifikuara;
  - ix. Sa më lart, në pamje të parë, mund të krijojë përshtypjen e një mosrespektimi plotësisht të parimit të kontradiktoritetit, dhe për rrjedhojë dyshimin mbi respektimin e procesit të rregullt ligjor, por këto dyshime janë zgjidhur në favor të prevalimit të një interesi madhor publik - nëpërmjet ruajtjes së konfidencialitetit të informacioneve të klasifikuara - duke u pranuar dhe duke u konsideruar i ligjshëm kufizimi i pjesshëm i të drejtave të palëve për tu njohur me provat dhe për të përgatitur mbrojtjen e tyre;
  - x. Ligjshmërinë e përdorimit të informacioneve të klasifikuara e ka konfirmuar edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila në vendimin e datës 19.09.2017, për çështjen me nr. 35289/11, - Ragner c/ Rep. Çeke, veç të tjerash është shprehur se:
  - xi. *“..... gjykatat kanë qasje të pakufizuar në të gjitha dokumentet e klasifikuara në të cilat autoriteti është bazuar vetë në mënyrë që të justifikojë vendimin e tij. Ata pastaj kanë Autoritetin për të kryer një shqyrtim të hollësishtë të arsyeve të mbështetura nga Autoriteti për moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara. Ata mund të vlerësojnë arsyet e dhëna për moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të atyre që konsiderojnë se nuk e garantojnë atë klasifikim ....”*
  - xii. *“.....e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është një e drejtë absolute. Në çështje penale ka gjetur se mund të ketë interesa konkurruese, siç është siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët në rrezik të hakmarrjes ose të mbajë sekret metodat e policisë për hetimin e krimit, të cilat duhet të vlerësohen kundrejt të drejtave të palës në gjykim ....”*

<sup>11</sup> Kundërshtimet janë shprehur në konkluzionet e tij, më datë 22.11.2018, duke hipotizuar se e njëjta dorë mund të ketë paraqitur gjithandej denoncime të njëjta, me keqdashësi kundër tij;

- xiii. *“... Në rastet kur provat nuk i janë vënë në dispozicion kërkuarit për arsye të interesit publik, gjykata duhet të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që, për aq sa është e mundur, t'i përmbahet kërkesave për të siguruar parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve dhe të ofrojë garanci të përshtatshme për të mbrojtur interesat e personit në fjalë .....*”
- xiv. *“... Dhoma konkludoi se arsyet për vendimin e mos- pasjes akses (moszbulimit) të dokumentit në fjalë nga ana e kërkuarit ishin bazuar në interesa të sigurisë kombëtare, sepse sipas autoriteteve, zbulimi mund të kishte pasur efektin e zbulimit të metodave të punës të shërbimit të inteligjencës dhe burimet e tij të informacionit ose mund të çonin në përpjekjet e kërkuarit për të ndikuar mbi dëshmitarët e mundshëm. Sipas Dhomës, procedura e vendimmarrjes plotësonte ‘aq sa ishte e mundur’ kërkesat e procesit të drejte dhe me ballafaqim dhe barazisë së armëve në proces dhe përfshinte mbrojtje të përshtatshme të të drejtave dhe interesave të aplikantit, dhe kështu nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 i Konventës ....”.*
- xv. Gjithashtu duhet qartësuar fakti që ligji konsideron të mjaftueshëm prezencën e problemeve serioze të një subjekti në lidhje me figurën, për shkarkimin e tij nga detyra, dhe jo prova përtej çdo dyshimi;
- xvi. Pra, sa më lart, çon në interpretimin që vetë ligjvënësi ka dashur të zgjerojë gamën e elementeve të përdorshme nga organet e “Vettingut”, mbi të cilat mund të bëhet vlerësimi përtej çdo dyshimi, mbi përshtatshmërinë ose jo të një subjekti të rivlerësimit.

Kështu që, në mënyrë të përmbledhur, Komisioni, vlerëson se:

- a- Për sa i përket përdorimit të informacionit të klasifikuar dhe argumentimit/pretendimit të subjektit të vlerësuesit, se nuk ka arsye të mjaftueshme për të mos e deklasifikuar me tej këtë informacion, pasi konsideron se:
- i. Trupi gjykues, nuk do të përdorë pjesët e padeklasifikuara të raporteve të DSIK-së në vendimmarrjen e tij. Kjo do të thotë që në këtë këndvështrim argumenti i subjektit konsiderohet jo pa rëndësi;
  - ii. Për sa i përket informacionit të klasifikuar nga institucionet verifikuese, në të cilat bazohen raportet e DSIK-së, për aq sa trupi gjykues do t'i përdorë këto informacione për vendimmarrje, nga ky i fundit çmohet se klasifikimi i këtij informacioni është i justifikuar;
  - iii. Moszbardhjen e arsyetimit të plotë, për vlerësimin se klasifikimi i këtij informacioni është i justifikuar, pasi kjo do të shkaktonte ekspozimin e informacionit të klasifikuar;
  - iv. Informacioni i klasifikuar, i verifikuar nga trupi gjykues, është në pjesën më të madhe i tillë, që ekspozimi i tij do të passillte edhe ekspozimin e burimeve të informacionit (të klasifikuar) si dhe metodat e punës së institucioneve verifikuese.

b- Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se:

- i. Shkaqet që çojnë në shkarkimin e subjektit i janë bërë të njohura subjektit ashtu si edhe pjesë të deklasifikuara të raporteve të DSIK-së, që trupi gjykues do të përdore për vendimmarrjen e tij;
- ii. Për atë që vendimi bazohet në informacion të klasifikuar të institucioneve verifikuese, trupi gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar kanë pasur akses në të dhe kanë pasur mundësinë të vlerësojnë rëndësinë dhe peshën e tij;
- iii. Veç të tjerash, vlen të theksohet se rezultati negativ i rivlerësimit të figurës nuk mbështetet vetëm në informacionin e klasifikuar, por gjithashtu, - veç pjesëve të deklasifikuara të raporteve të DSIK-së, - ai është bazuar edhe në burime të tjera informacionesh të paklasifikuara, siç janë në dosjet e administruara nga prokuroria dhe ankesat, të cilat i janë bërë me dije subjektit;
- iv. Në sajë të sa më lart, trupi gjykues çmon se në rastin konkret ekziston një ekuilibër i drejtë midis respektimit të të drejtave të subjektit të rivlerësimit dhe të nevojës për të mbrojtur informacionin e klasifikuar.

c- Për sa i përket, informacionit të klasifikuar, në vetvete, trupi gjykues vlerëson sa vijon:

- i. Informacioni i klasifikuar i përdorur nga trupi gjykues për vendimmarrje për rivlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit është specifik, i detajuar dhe gjithëpërfshirës;
- ii. Ky informacion mbështetet nga informacionet e administruara edhe nga dosjet e prokurorisë, të cilat janë verifikuar nga trupi gjykues dhe i janë vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit;
- iii. Informacioni është në linjë me përmbajtjen e denoncimeve të paraqitura pranë Komisionit;

d- Për sa i përket **rezultatit të vlerësimit të Figurës**, trupi gjykues, bazuar në informacionin e lartpërmendur arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, paraqet probleme serioze, pasi ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Ky përfundim bazohet në gjetjet e mëposhtme:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte, më shumë se një herë, me një person të quajtur H. M.;
- ii. Një person i quajtur P. B., i cili ka qenë në kontakt dhe komunikim me shtetasin H. M., ka nisur një mesazh i cili përmban emrin e subjektit. Fakti, i pretenduar/referuar nga subjekti, se në Shqipëri ka 12 persona me të njëjtin emër të subjektit, nuk është bindës, për sa kohë që nuk ka elementë tregues se këta persona kanë pasur kontakte me H. M.;
- iii. Shtetasi H. M., është një person i përfshirë në krimin e organizuar siç përcaktohet në nenin 3 të ligjit nr. 84/2016;

- iv. Trupi gjykues ka konstatuar se ka tregues të fortë se kontaktet ndërmjet subjektit dhe shtetasit H. M. kanë qenë disa, jo rastësore, dhe të papërshtatshme. Subjekti pranon vetëm një kontakt, të cilin ai e cilëson si të rastësishëm, ndërkohë që është konstatuar fakti se në të vërtetë ka pasur më shumë kontakte midis tyre dhe të paktën një kontakt të drejtpërdrejtë, që nuk mund të konsiderohet si një rastësi. Gjithashtu përfshirja e subjektit në lidhje me çështjen ku shtetasi H. M. ishin përfshire çon në drejtim të papërshtatshmërisë së këtij kontakti. Për më tepër, përmbajtja e denoncimeve e mbështet këtë papërshtatshmëri.

### **Në lidhje me kontrollin e figurës:**

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe jo me vërtetësi. Nga analiza e të dhënave të parashikuara në pikën 1, neni 38, i ligjit nr. 84/2016, dhe kryesisht bazuar në raportin e DSIK-së, por edhe në dokumente të tjera, përfshirë këtu edhe dokumentacionin e klasifikuar, rezultoi që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe mund të vihet nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë konkludohet se ai është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se **lidhur me kriterin e figurës, subjekti i rivlerësimit, ka kryer deklaramit të pasaktë dhe të pavërtetë, si dhe ka pasur kontakte të papërshtatshme. Rrjedhimisht, bazuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, nenit 38, 39 dhe pikës 2 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ky subjekt vlerësohet i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës,**

**Duke mbajtur parasysh që:**

- 1- Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të pamjaftueshëm referuar pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe parashikimeve të nenit D, pika 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës;**
- 2- Në lidhje me kontrollin e figurës, bazuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, nenit 38, 39 dhe pikës 2 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës së tij;**

**Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel besueshmërie, për sa i përket vlerësimit të pasurisë dhe të kontrollit të figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a” dhe “b”.**

Në këto kushte Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjektit të rivlerësimit, z. Shpëtim Kurti, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D, pikat 1, 3, 5 dhe nenin DH, pikat 3 e 4, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c” dhe pikave 2 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Shpëtim Kurti, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 23.11.2018.

### **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Brunilda Bekteshi**  
**Kryesuese**

**Lulzim Hamitaj**  
**Relator**

**Roland Ilia**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Denisa Kosta*